



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 966

Datë: 24.07.2020

PROCESVERBAL

i mbledhjes së III-të (tretë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -XI-XII të vitit 2019, dhe mbledhjes së -II-2020.
2. Shfuqizimi i vendimit nr.02/520 datë:12.09.2019, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të z. Kaqanik Balaj nga fshati Zabllaq Komuna e Istogut, sipas vlerësimit nr.3817/2 datë:26.11.2019 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Shfuqizimi i vendimit nr.02/521 datë:12.09.2019, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të z.Egzon Gashi nga fshati Ngucat Komuna e Malishevës, sipas vlerësimit nr.3818/2 datë:26.11.2019 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
4. Emërimi i anëtarëve të Komisionit për Hartimin e Rregullores për Kriteret e Ndarjes së Çmimeve, Dekorativave dhe Mirënjohjeve.
5. Informimi për aktivitetet e KKS-së për vitin 2019.
6. Shqyrtimi i raportit vjetor nr.01/433 datë:19.05.2020 i punës së Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2019 (Janar-Dhjetor 2019).
7. Bartja e mjeteve financiare nga viti 2018, 2019 në vitin 2020.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/410 datë:12.05.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, lidhur me zbatimin e kontratës kolektive të Arsimit dt.17.04.2017.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/416 datë:14.05.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës për gjetjen e mundësisë së zgjidhjes për familjet të cilat duhet të zhvendosen me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në lagjen Matoshi në Malishevë.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve dhe emërtime të reja.
11. Shqyrtimi dhe paraqitja në debat-konsultim publik i draft-Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve.
12. Shqyrtimi i raportit të pasurisë jo financiare në Komunën e Malishevës.
13. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Drejtorisë për Inspektorat për vitin 2019
14. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të Komitetit për Komunitete për vitin 2020.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit Janar-Dhjetor 2020 të Komitetit për Diasporë.
16. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Planit të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020.
17. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 29.05.2020 dhe filloi në ora 10:20.

Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 25 asambleistë, Kryetari i Komunës drejtorë komunalë, LMT-ja, përfaqësuesi i OSBE-së, dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë! Sipas kërkesës së KPF-së mbledhja mbahet në Shtëpine Kulturës “Tahir Sinani”, këtu në Malishevë për shkak që jemi në kohë pandemie dhe ta ruajmë distancën për mbrojtjen e shëndetit. Sa i përket kushteve të sallës, jam i informuar që ndriimi nuk është në nivelin e duhur, por ne duhet ta mbajmë këtu këtë mbledhje. Korrumin e kemi dhe jemi të pranishëm në këtë mbledhje 25 asambleistë. Mungojnë: Demir Bajra, Abetare Limaj, Kushtrim Zogaj, Raimonda Krasniqi, Florentina Zulfaj, dhe Fjoralba Kryeziu në këtë fillim të mbledhjes.

Fatmirsisht tani për tani K. e Malishevës e ka kaluar fazën e vështirë të infektimit dhe kemi veç një rast me COVID-19 dhe të gjithë të tjerët janë shëruar.

Kërkoj nga ju këshilltarë komunalë që të gjithë ju që nuk e keni deklaruar pasurinë, ta deklaroni sa më parë.

E hapi debatin e jashtë rendit të ditës.

Valon Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Kam për t'i paraqitur disa shqetësime të qytetarëve në K. e Malishevës. Në fshatin Kërvasari është një rrugë që lidh fshatin Kërvasari-Nishor e që është shtruar me zhavor para një viti e që po demtohet ajo shtresë sepse nuk është shtruar me asfalt. Kur pritet që të asfaltohet kjo rrugë?

Një rrugë tjetër po në Kërvasari është në lagjen “Imerajt”, që është grryer e lënë ashtu e që është e vështirë e kaluaeshme për banorët e asaj lagje. Kur do të shtrohet kjo rrugë?

Kërkesa tjetër është nga banorët e fshatit Dragobil për qentë endacakë. Është mirë që këtë rrezik ta parandaloni sa më parë.

Kam një kërkesë për Drejtorinë e Inspektoriatit që të inspektojnë dhe së bashku me Drejtorinë e Shërbimeve Publike të bëjnë largimin dhe pastrimin e furrës së gëlqerës në fshatin Bardh.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Kryetar, Kryesia e fshatit Carrallukë ju ka drejtuar me 2 kërkesa për rregullimin kanalizimit në lagjen “Haxhaj” sepse gjendja është shumë e keqe rrezikohet edhe jeta e fëmijëve. Kryetar ju e patët premtuar rregullimin e atij kanalizimi, por asgjë nuk keni bërë.

Kërkesa e 2-të është për urën që është te shkolla fillore “Imer Krasniqi” në Carrallukë e cila nuk ju bënë ballë vershimeve ja fotografinë e që rrezikon e dëmton shumë ato shtëpi për rreth dhe shkollën. Kërkoj që të merrni masa për këto 2 kërkesa të fshatit Carrallukë Kryetar!

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Shqetësimi i të gjithë grave të Malishevës dhe i imi është transporti urban. Ka shumë herë që e kam ngritur këtë çështje e asnjëherë nuk kam marrë përgjigje për këtë.

Kam kërkuar gjithashtu që rruga “Ëilam Voker” të lidhet me tranzit, mirëpo nuk ka asgjë konkrete që a mund të asfaltohet kjo rrugë sepse aty po hudhen mbeturinat e kërkoj që edhe inspektoriati të del aty për inspektim.

Arbëreshë Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Kryesues për mbajtjen e mbledhjes në këtë sallë kushtet janë të pavolitëshme dhe kërkoj që sa më shpejt të përfundoj kjo mbledhje e të mos kemi debate të stërtepruara.

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë! Shqetësimi im është për dëmtimin e një pjese të shkollës së vjetër në Bubavec nga disa njerëz të papërgjegjshëm kjo është edhe si pasojë e mungesës së rrethojës e që e kemi kërkuar që 2 vjet uroj që këto projekte që mos të vonohen më. E përmendi edhe Valoni shqetësimin për qentë endacakë e që po paraqesin rrezik për të gjithë.

Rrahim Morina: Në mbledhje erdhën Abetarja, Raimonda, Kushtrimi

Nebih Bibaj: Pershendetje për të gjithë! Shqetësuese edhe për mua janë qentë endacakë e sidomos këta që po sillen nëpër qytezën e Malishevës e këtu afër komunës. Kjo çështje duhet zgjidhur njëherë e përgjithëmonë.

Kryetar, gjithëmonë jeni thirrur në luftën e UÇK-së por rruga “Agim Çela” që 5 vjet është në projekt por nuk është shtruar. Ajo rrugë mbanë një emër të madh e është dashur që të shtrohet kohë më parë e qoja amanetin në vend dëshmorëve.

Shumë mirë që e keni renovu labidarin në Lladroc por pse nuk ka përfunduar projekti veç për 9 poça ndriçues.

Banorët e fshatit Ngucat kanë shpreh shqetësimin për rrugën “Kalaja” e cila ëshjtë në projekt-buxhet por shtyhet shtrimi i saj.

Banorët e fshatit Lladroc disa herë kanë shprehur shqetësimet e tyre për rrjetin energjistik kështu që Kryetar kërkoj nga ju që të shfrytëzoni autoritetin e juaj e të shtroni presion ndaj KEDS-it.

Alban Krasniqi: Shqetësimi im ka të bëjë me keqpërdorimin e parasë publike për COVID-19 dhe për spërkatjen e rriqërve. Nga informacionet që kam siguruar ng l-prokurimi dhe çështjet tjera kam vë re që ka shkelje të rënda si në shpalljen e tenderit ashtu edhe në keqpërdorimin e parasë publike. Për deinfektimin e rriqërave ne si Kuvend i kemi ndarë aq mjete sa janë kërkuar për nevojat e dezinfektimit të hapësirave publike. Kabina për dezinfektim që është vendosur në oborr të shtëpisë së shëndetit ka kushtur 4,700€ e cila veç një javë ka funksionuar, ndërsa në Lipjan e njëjta ka kushtuar 1,500€. Pra shuma e kësaj kabine ka qenë 300% më e rritur se çmimi real. Kryetar e dimë që ju keni bërë një marrëveshje alla-mafioze me kompaninë “Zona Park” dhe keni vendosur për çmime ashtu siç keni dashur ju. Kryetar nuk ka logjikë që 68€ me kushtu ari në Minsitri dhe 17€ ari në komunë për punën e njëjtë dhe nga kompania e njëjtë. Pra dëmtimi i buxhetit për këtë tender për komunën është 15,000€.

Filloreta Bytyqi: Pershendetje për të gjithë! Fillimisht i përshendes të gjithë ata që dhënë kontributin në luftën kundër pademisë dhe kanë qëndruar në vijën e parë të frontit!

Gjithaashtu e flemnderoj edhe Vlonin sepse i përmendi 2 rrugë të fshatit tonë, e kam prmendur këtu që ato rrugë janë projekte 2-vjeçare dhe besoj që mbrenda kësaj periudhe këto projekte edhe do të realizohen.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kryetar, në hyrje të Malishevës nga fshati Banjë rruga “Gjergj Kastrioti-Skenderbeu” është e prishur dhe ju çdo ditë asaj kaloni dhe paraqet rrezik edhe për aksidente.

Në rrugën “Imer Krasniqi” është një pusetë e hapur që paraqet rrezik, gjithashtu e dëmtuar është edhe rruga “Ibrahim Mazreku”.

Kryetar, çka po ndodh me rregullimin e shtratit të lumit Mirusha, ka më shumë që 1 vit që kemi marrë vendim për shpronësim e ndërsa çështja vazhdon të jetë e bllokuar?

Kryesues, propozoj që pjesën tjetër të mbledhjes ta vazhdojmë në sallën e Kuvendit Komunal për shkak të kushteve jo të volitëshe këtu!

Rrahim Morina: Mbase është Raporti i Kryetarit në rend dite ai kërkoi që t'u përgjigjet kur diskutohet kjo pikë. Mirë që u pajtuat.

Kalojmë në debatin për rendin e ditës. Materialin e keni marrë me kohë përveç një propozimi shtesë që e ka sjellë Kryetari dje. Kërkesa e Kryetrit është kjo: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/462 e datës 27.05.2020 e parashtruar nga Kryetari i Komunës lidhur me kërkesën nr. 01/166 05.03.2020 e parashtruar nga Operatori i njësisë së Transmisionit KEK për ndërtimin e nënstacionit në Malishevë. E hapi debatin për rendin e ditës.

Avdi Morina: Pershendetje për të gjithë! Duke e parë këtë situatë në kohë pandemie jo që ka prekur të gjithë qytetarët por edhe bizneset ne si gurr politik kërkojmë që në rendin e ditë të futet një pikë- Të lirohen të gjitha bizneset e K. së Malishevës për vitin 2020 të lirohen nga taksat komunale.

Kushtrim Zogaj: Pershendetje për të gjithë! Ne grupi ynë i PDK-së kërkojmë që pika e 10-të e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen tjetër për shkak që materiali është voluminoz dhe na duhet më shumë kohë për ta analizuar.

Alban Krasniqi: Ne e dimë që pandemia jo që ka ndikuar veç tek bizneset por te secili qytetar i vendit. Natyrisht që duhet t'i ndihmojmë bizneset, por jam që kjo çështje të analizohet në ditët në vijim dhe vendimin ta marrim për tërë vitin e jo patjetër ky vendim të merret në këtë mbledhje. Mendoj që pika e 10-të duhet të diskutohet sot sepse kjo çështje është që një kohë të gjatë dhe ne duhet të marrim një vendim për këta emra.

Arbreshë Krasniqi: Ne si grup e kemi diskutuar çështjen për lirimin e nga taksat komunale të bizneseve të Malishevës për shkak të pandemisë t'i ndihmojmë këto biznese dhe qytetarët në formë të ndryshme. Ne duhet t'u japim këtë mundësi këtyre bizneseve nga ky Kuvend dhe është mirë që sot të diskutohet si temë.

Gjithashtu është mirë që sot të diskutohet edhe pika e 10-të sepse ai raport i atij komisioni mendoj që është versioni më i mirë për të emërtuar ato rrugë të cilat kanë qenë të nevojshme.

Sylë Dukolli: Jam anëtar i Komisionit për Emërtimin e Rrugëve dhe aty është bërë një punë e madhe dhe janë mbajtur takime të shumta. Jam i kënaqur me punën që është bërë aty dhe është mirë që ky raport të kalojë në këtë Kuvend.

Alban Mazreku: Ne PDK-ja nuk jemi kundër raportit, po kërkojmë kohë që të analizohet ky raport më shumë pasi një pjesë e raportit u dorëzua sot këtu, dhe nuk kemi kushte të përshtatshme për ta lexuar pasi jemi në këtë sallë.

Avdiu propozoi për lirimin e bizneseve nga taksat komunal por nuk dha asnjë sqarim tjetër. Ne PDK-ja kemi qenë gjithmonë që bizneset të lirohen nga këto taksa por ne mendojmë që ky propozim i Avdiut mos të futet në rendin e ditës për shkak të kushteve të pandemisë kësaj çështje t'i bëhet një analizë pak më e thellë.

Arbëreshë Krasniqi: Alban, nëse shtyhet kjo pikë mendoj që do të jetë vonë për një raport tjetër, por le të del Kryetari i Komisionit dhe le ta sqarojë më detajisht këtë çështje dhe mendoj që raporti është i përgatitur mirë dhe nuk ka nevojë për emërtim rrugë që është i padëshiruar.

Kryesues, kjo sallë nuk i plotëson kushtet për mbajtjen e mbledhjes, është mirë që mbledhjen ta vazhdojmë në sallën e Kuvendit.

Kastriot Berisha: Sa i përket propozimit të NISMA për lirimin nga taksa të bizneseve kam një pyetje. A keni bërë propozimin për lirimin nga taksa komunale të të gjitha bizneseve apo vetëm atyre që janë të NISMA?

Alban Mazreku: Komisioni për Emërtimin e Rrugëve ka bërë një punë të mirë edhe pse është e ndjeshme. Ne kemi pasur përfaqësuesin tonë aty, mirëpo për hirë të korrekctsisë ne kërkuam pak kohë për leximin dhe analizimin e këtij raporti prandaj kërkuam që të shtyhet.

Avdi Morina: Kastriot, propozimi ynë është për të gjitha ato biznese që janë të regjistruara pa dallim që të lirohen nga taksa komunale.

Rrahim Morina: Kërkoj me mirëkuptim të plotë që ju si NISMA që ta tërhiqni propozimin e Avdiut për lirimin e bizneseve nga taksa komunale deri në analizimin e situatës pasi që jemi në kushte pandemie. Neve na duhet kohë që ta përgatitim këtë çështje.

Arbëreshë Krasniqi: Me ardhjen e NISMA në qeveri prej 2013 deri në 2 vitet e fundit ne kemi liruuar të gjitha bizneset nga taksa komunale. Ne nuk po e bëjmë tani, e kemi kemi bërë edhe në të kaluarën. Megjithatë ne po pajtohemi që ky propozim të shtyhet që të bëhet një kërkesë e kompletuar e ta analizojmë këtë situatë pandemie edhe më shumë.

Rrahim Morina: Meqë u pajtuat që të hiqet propozimi i Avdiut fillimisht unë do ta hedh në votim kërkesën e PDK-së që të largohet nga rendi i ditës pika e 10-të. Atëherë kush është për që të largohet nga rendi i ditës pika e 10-të?

Për: 11

Kundër: 19

Abstenim: 0

Me këtë votim kjo pikë mbetet në rendin e ditës.

Propozimi që të futet në rendin e ditës është edhe kërkesa e Kryetarit. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/461 dt. 27.05.2020 e parashtruar nga Kryetari i Komunës lidhur me kërkesën me nr. 01/136 e dt. 05.03.2020 e parashtruar nga operatori i tregut KOS, SHA- Prishtinë për sigurimin e lokacionit për ndërtimin e një nënstacioni... kush është për?

Për: 30 (unanimisht)

Me këtë votim unanim kjo pikë futet në rendin e ditës menjëherë pas procesverbalit.

Kush është pro aprovimit të rendit të ditës në tërësi me plotësime?

Për: 29

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me këtë votim aprovohet edhe rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e 1-rë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -XI-XII të vitit 2019, dhe mbledhjes së -II-2020. E hapi debatin për këtë pikë.

Kush është pro miratimit të këtyre procesverbaleve?

Për: unanimsisht

Ne kemi dy vendime që vendi sipas MAPL-së ju ka shkruar Prizren dhe ka qenë kërkesë e juaja që t'i kthejmë në MAPL, por ato duhet që t'i shfuqizojmë. Kush është pro shfuqizimit të këtyre 2 vendimeve sipas pikës 3 dhe 4 të rendit të ditës?

Për: unanimsisht

Me këtë votim shfuqizohen të dy ato vendime që ka kërkuar MAPL-ja.

Shkojmë në pauzën e drekës dhe më pas mbledhjen e vazhdojmë në sallën e Kuvendit.

Vazhdojmë pas pauzës së drekës. Kalojmë në pikën e 4-ërt të rendit të ditës që është Kërkesa e Kryetrit. Fjalën e ka Muharremi.

Muharrem Morina: Pershendetje për të gjithë! Ne kemi pranuar një kërkesë nga ndërmarrja publike KOS për rikofirmim të loacionit për vendosjen e kësaj njësie. Në vitin 2012 ish-kryetari e ka dhënë një pëlqim për vendosjen e trafo-stacionit. Ata kërkjnë që ta marrin në pronësi këtë sipërfaqe 85 ari. Në kërkesë e kenë të sqaruar që komuna nuk e ka të drejtën që pronësinë e me ja dhënë, por ka të drejtë për një afat të caktuar 99 vite ta jap për shfrytëzim. Mbasi vendimi merret këtu, procedurë konkurse nuk do të ketë dhe vendimi do të shkojë në MAPL dhe në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe kështu çështja do të kopletohet e të fillohet me implementimin e projektit.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë. Propozoj që për shkak të materialit të shumtë të shkojmë në diskutim në nivel të shefave të grupeve.

Sylë Dukolli: Ne e përkrahim si grup këtë kërkesë dhe urojmë që ky projekt të realizohet e të përmirësohet situata me energji elektrike.

Alban Mazreku: Muharremi e përmendi që është ndarë një pëlqim për këtë çështje edhe në vitin 2012, por këtë herë ndoshta e marrin më seriozisht këtë investim. Muharrem, a ndryshon parcela apo është e njëjta? Një kërkesë e tillë është që 8 vite e ndoshta KOS tani seriozisht do të investojë. Ne si grup e përkrahim këtë kërkesë.

Valon Krasniqi: Edhe ne LDK-ja e përkrahim këtë kërkesë.

Alban Krasniqi: Normalisht që projektet që janë në dobi të qytetarëve ne do ti përkrahim, por ne jemi këtu edhe për t'i trajtuar dokumentet dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me projektin. Këtu u përmend një pëlqim i viti 2012 që për mua është i dyshimtë sepse Kryetari i Komunës nuk ka të drejtë të jup në shfrytëzim pronën publike pa vendimin e Kuvendit. Nëse është fjala për të njëjtën parcelë atëherë si do të marrim ne vendim, për një vendim i cili aktualisht është në shënimet kadstrale ku shenohet që shfrytëzuese e asaj parcelë është KEK për 99 vite?! Ju po kërkon aktualisht një pronë që është në shfrytëzim të KEK-ut. Saqrona neve këtë sepse ne duhet të dimë se çfarë vendimi po marrim. Nëse ne duhet t'ja marrim KEK-ut këtë pronë dhe me ja dhënë KOST-it atëherë tregona këtë punë.

Rrahim Morina: Kërkoj sqarime edhe unë për këtë çështje.

Bashkim Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Në bazë të një pëlqimi që ju e keni u është dhënë e drejta e shfrytëzimit kësaj korporate në afat të përkoshëm. Me këtë pëlqim është regjistruar në kadastër për 99 vite e që është e regjistruar gabimisht sepse është dshur që të regjistrohet në certifikatën e pronës me afat të përkohëshëm ose të specifikohet se cili është afati që jepet në shfrytëzim. Gjithmonë duhet të ketë një vendim të Kuvendit kur jepet në shfrytëzim një pronë publike dhe më pas duhet të lidhet kontrata në mes kompanis apo personit juridik dhe kryetarit dhe ajo kontratë duhet të regjistrohet në kadastër me të gjitha ato kushte që janë paraparë.

Në këtë rast Kuvendi mund të marrë vendim, që mbrenda vendimit të shfuqizohet ai pëlqim dhe më pas të bëhet kontrata tjetër e të regjistrohet për sa vite jepet në shfrytëzim parcela. Parcela është e njëjta, sipërfaja është e njëjta

Muharrem Morina: Pëlqimi atëherë është dhënë në afat të shkurtër që investimi të mos ik. Kur është regjistruar në Kadastër është bërë një gabim sepse pëlqimi nuk duhet të regjistrohet për dhënie të pronës në shfrytëzim. Tash për ta regjistruar si pronë këtë në kadastër duhet vendimi i Kuvendit. Tash pëlqimi duhet të bie poshtë e të marrim një vendim të ri.

Hashim Vrenezi: Në këtë pëlqim shkruan arsyetimi se pse është nxjerr ky vendim. Këtu thuhet që Opertaori i Transmesionit të Tregut dhe Tregu i KOST-it. Ndërsa te pjesa listës poseduese

shkruan Korporata Energjetike dhe afati 99 vite. Në pëlqim nuk shkruan askund 99 vite. Pëlqimi është marrë nga Kryetari i Komunës dhe nëse është në shpërputhje atëherë mund të shfuqizohet po nga Kryetari i Komunës sepse është i të njëjtit nivel të hirarkisë. Më pas Kadastra le t'i korrigjoj gabimet që i ka bërë. E më pas ne e rregullojmë këtë çështje.

Muharrem Morina: Qëllimi kur është dhënë ky vendim ka qenë që të ndalet investimi nyuk po them as që është as i ligjshëm e as i paligjshëm. Letrat i keni para jush.

Tash duhet që ta shfuqizojmë atë pëlqim, e dhënë në shfrytëzim pronën, e lidhimin kontratën dhe hynë KOST në posedim për 99 vite apo për sa vite ju vendosni e jo në pronësi.

Rrahim Morina: Shkojmë me propozimet se për sa vite do ta japim në shfrytëzim atë pronë. Kryetari ka propozuar që prona të jepet në shfrytëzim për 99 vite.

Arbëreshë Krasniqi: Ne kërkuam sqarime për çështjen e votimit. A duhet ta shfuqizojmë pëlqimin e mëhershëm, apo ne duhet të biem në lajthitje që të votojmë e të marrim vendim mbi vendim. Këtë nuk e saqruat mirë! Unë vendim mbi vendim nuk marrë. Kërkoj sqarime shtesë edhe pse ne si grup e përkrahim këtë kërkesë dhe propozoj të jepet për 99 vitë në shfrytëzim.

Bashkim Krasniqi: Ligji për Kadastër thotë: çdo punëtor sipas pozitës zyrtare mund t'i përmirësojë gabimet teknike nëse i vrenë që ato ekzistojnë. Me anë të kësaj dispozite ligjore të bëjmë përmirësimin e gabimeve teknike që janë bërë gjatë regjistrimit. Mirëpo me vendimin që merret në Kuvend ne e regjistrojmë prap afatin kohor ashtu siç është në vendim dhe ashtu në certifikatën e pronës së shfrytëzimit.

Alban Mazreku: Edhe ne propozojmë që kohëzgjatja të jetë për 99 vite dhe ne nuk votojmë për shfuqizimin e pëlqimit sepse ai po i përgjigjet kërkeset veç votjmë për kohëzgjatje.

Valon Krasniqi: Ne mendojmë që kjo pronë të jepet në shfrytëzim për 99 vite si Ldk.

Alban Krasniqi: Pvarsisht atyre sqarimeve të buta që u dhanë edhe ne po pajtohemi që të jetë për 99 vite.

Rrahim Morina: Shkojmë në votim për shfuqizimin e pëlqimit nr. 01/1090-12 të datës 14.12.2012. Kush është për?

Për: 16

Kundër: 6

Abstenim: 2

Me këtë votim shfuqizohet pëlqimi i vitit 2012.

Kalojmë në kërkesën e Kryetarit për ndarjen e lokacionit 85 ari për ndërtimin e një nënstacioni nga KOST-i për 99 vite. Kush është për?

Për: unanimit (25)

Me këtë votim miratohet kërkesa e Kryetarit.

Kalojmë në pikën e 5-të të rendit të ditës: Emërimi i anëtarëve të Komisionit për Hartimin e Rregullores për Kriteret e Ndarjes së Çmimeve, Dekoratave dhe Mirënjohjeve. Shkojmë me propozimet e anëtarëve për këtë komision.

Arbëreshë Krasniqi: Ne Nisma propozojmë Sylë Dukollin për këtë komision.

Alban Mazreku: Ne PDK-ja propozojmë Hamëz Bytyqin.

Leonita Kastrati: Grupi ynë i LDK-së propozon Valon Krasniqin si anëtarë të këtij komisioni.

Alban Krasniqi: Ne VV-ja propozojmë Ilaz Krasniqin.

Florentina Zulfaj: Ne propozojmë Kastriot Berishën.

Rrahim Morina: Propozimi nga Zyra e Kryetarit është për Muharrem Morinën dhe ka mbeteur mangu edhe përfaqësuesi nga shoqatat e dalura nga lufta. Komisioni i ka 7 anëtar të propozuar ata janë: Sylë, Hamza, Valoni, Ilazi, Kastrioti, Muharremi dhe anëtari nga shoqatat e dalura nga lufta që e sjellin ata. Kush është për?

Për: unanimit (22)

Me këtë votim kompletohet edhe ky komision.

Kalojmë në pikën e 6-të të rendit të ditës: Informimi për aktivitetet e KKS-së për vitin 2019. Halit Mazreku e ka fjalën.

Halit Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Këshilli për Siguri në Bashkësi është organ këshillues për sigurinë në bashkësi për të gjitha komunitetet. Komuna e Malishevës rreshtohet si një ndër komunat me siguri të lartë.

Ky Këshill gjatë këtij viti ka mbajtur 6 takime të rregullta. Të gjitha aktivitetet janë zhvilluar sipas Planit të Punës që është i hartuar për këtë vit.

Çështjet të cilat gjatë këtij viti i kemi shtjelluar janë infrastruktura, ethet hemorragjike, siguria në shkolla, rutja e ambientit si dhe masat e parandalimit të ndezjes së zjarreve e sidomos në kohën e verës, kafshët e braktisura, pjesëmjarrja e qytetarëve në lufta të tjera etj.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Isha njëri ndaj ata që kam insistuar që të raportohet nga ky Këshill para Kuvendit e mendoj që kjo të praktikohet edhe në të ardhmen. Në këtë raport informues nuk është informacioni i detajuar për dhunën në familje do ishte mire që kjo të plotësohet.

Qentë endacakë janë problem për shoqërinë dhe është mirë që të ngritet ajo strehimore që përmendet.

Në raport përmendet masat që janë për parandalimin e përdorimit të drogës nëpër shkolla, por a ka ndonjë rast që kjo ka ndodh në shkollë, pra përdorimi i drogës?

Në fshatin Bardh është bërë djegja e gomave për gëlqere që tani më duket që është ndal por është dashur të paraqitet si problem këtu.

Është mirë që raporti të jetë më i kompletuar më mirë që t'i njohim më mirë problemet që po ndodhin në komunën tonë në mënyrë që ne t'i luftojmë si duri e nësë mundemi që edhe t'i parandalojmë.

Rrahim Morina: Kalojmë në pikën e 7-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit vjetor nr.01/433 datë:19.05.2020 i punës së Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2019 (Janar-Dhjetor 2019). Kryetari e ka fjalën.

Kryetari- Rgip Begaj: Pershendetje për të gjithë! Këtë raport e keni edhe në faqen zyrtare të komunës. Jemi në kohë pandemie dhe Malisheva ka qenë më më shumë raste por bashkëpunimin e juaj kemi arritur se ta mëxhanojmë mirë këtë situatë sepse tash veç një rast është aktiv. Janë marrë vendime të shumta si dhe janë zbatuar ato që janë marrë nga niveli qendror.

I falemnderoj të gjithë ata donatorë që e kanë ndihmuar komunën në këtë situatë dhe për këtë jam duke përgatitur një raport.

Bazuar në arritjet dhe përpjekjet e realizuara mund të themi që viti 2019 ka qenë i suksesshëm për komunën tonë. Edhe në këtë vit kemi fitu luftën me Ethet Hemorragjike pasi që është viti i 6-të që nuk kemi asnjë rast me vdekje dhe viti i 5-të pa asnjë rast të infektuar.

Ka pasur edhe shumë investime kapitale që ka ndikuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Këto investime janë bërë në rrugë, kanalizime, ujësjellës, shkolla, shëndetësi, ndriçim publik, investime në bujqësi etj.

Përqindja e tërësishme e buxhetit të komunës e shpenzuar për vitin 2019 është 90.24% .

Gjatë vitit 2019 kam marrë 634 vendime të ndryshme.

Në këtë raport i keni të pasqyruara edhe raportet e drejtorive si dhe të zyrave të veçanta që janë në kuadër të menaxhimit.

Po ju përgjigjem edhe pyetje që keni parashtruar para debatit për rendin e ditë.

Valon, rruga në Kërvasari është në proces, e tenderuar, kontrata është bërë dhe së shpejti do të fillon që të shtrohet.

Qenët endackë janë shqetësim edhe për ne dhe ne e kemi një stacion të veterinars këtë dhe ai është duke u marrë me këtë çështje dhe së shpejti do të ndajmë edhe buxhet për këtë problem.

Ilaz, e kam vizituar atë kanalizim në Carrallukë dhe shumë shpejt do të rregullohet edhe ai.

Hidajete ju pyetet për rrugën “Ëlilam Ëoker”. por ju e dini që kemi pak problem me çështjen e pronave në Malishevë dhe kemi pasur disa takime me qytetarët për ta shtruar atë rrugë por nuk kemi arritur asnjëherë marrëveshje me ata qytetarë.

Nebih, rruga “Agim Çela” është në procedura dhe së shpejti do të shtrohet edhe ajo, veç mos harroni që jemi në kohë pandemie e disa investime kanë pasur edhe ngecje. 4

Alban, rrugën Malishevë-Banjë e kemi në procedurat e tenderimit dhe besoj që do të përfundoj sivjet. Ndërsa sa i përket investimit rreth dy anëve të lumit Mirusha kemi hasur në pengesa për shkak të pronës nga qytetarët, prandaj edhe realizimi i projektetit po vonohet.

U mundova që t'u përgjigjem edhe pyetjeve të juaja, falemnderit!

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Sylë Dukolli: Raporti është tepër voluminoz dhe ndoshta për të ardhmen të jetë një seancë e veçantë veç për raportin e Kryetarit. Ky raport paraqet aktivitetet e shumta të punës së Kryetarit. Është mirë që herave tjera kur ta planifikojmë buxhetin është mirë që të planifikohet me m² për rrugë. Jo të ndahen 600,000€ për shtrimin e rrugëve për buxhet, e të shtrohen 2 mil€ rrugë sepse netani po kërkojmë shtrimin e tyre.

Kërkoj që raportet e drejtorive të ndahen nga raporti i Kryetarit këtu sepse ne po kërkojmë që secila drejtori veç e veç të raportoj këtu, atëherë ta lirojmë Kryetarin nga kjo që ai të raportoj veç për puntë e veta.

Hidajete Mazreku: Ky raport shume voluminoz dhe ka shumë gjëra që neve nuk na hynë në punë. Ne dëshirojmë të dimë vetëm se cilat punë i ka kry Kryetari? Këtu janë përfshirë të gjitha drejtoritë edhe pse po raportojnë ato këtu. Mendoj edhe unë si Sylë që të mbajmë një seancë të veçantë për raportin e Kryetarit.

Kryetar, investimet kapitale janë realizuar shumë pak edhe atë në fund të vitit. Kush është fajtori për këtë? Kryetar është mirë që t'i specifikoni vetëm aktivitetet e juaja heren tjetër. Cilat janë shërbimet kontratuese tjera? Cilat janë ato vendime gjyqësore që e kanë shpenzuar buxhetin shumë?

Alban Krasniqi: Raporti pavarësisht që janë inkuadruar disa drejtori ka informacione të mangëta dhe i tepërt me material. Raportet duhet të jenë në ëynë më të kopresuarar dhe pa ja humb faren përmbajtjen dhe gjuhësisht të jetë më i shkruar mirë.

Ka fjatorë dhe keqpërdorues në këtë raport edhe të fondeve edhe të kryerjes së detyrave si dhe tejkalimin e kompetencave edhe nga ana e juaj Kryetar. Përformca matet me treguesit se sa ju ju keni bërë qytetrëve jetën e jetushme këtu, jo që numri i braktisjes së vendit veç po rritet çdo ditë. 700 familje janë me asistencë socilaë, çka keni bërë ju për ta Kryetar se sot këtu dëgjova veç për bizneset. Nderrojeni qasjen, bëhuni qeverisje për qytetarët.

1,200,000.00€ kjo qeveri i ka humbur në 2019, e për këtë askush deri me tani nuk foli. Nuk kërkoj falje për këtë Kryetari që kanë humb edhe pse kemi mund t'i ridestinojmë. Ja po ju përmendi rend projektet dhe investimet ku janë bërë keqpërdorimet duke fillu që nga tenderimi. Kryetar, pse nuk po zbatohen vendimet e Kuvendit siç është ai për heqjen e billbordave, pse Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk po i merr masat?

Kryetar këto dhe ato tjerat i thash nuk po më duhen përgjigjet e juaja sepse e di se çfarë përgjigje jep. Ti jep justifikime për ta fsheh krimin.

Rrahim Morina: Unë sa i përketë këtij raporti do të fokusohem në tri çështje

- Menaxhimi dhe pranimi teknik i projekteve, (menaxhimi është tepër i dobët dhe pranimi i projekteve bëhet akoma pa përfunduar.
- Ndërrimi dhe devijimi i projekteve, ka shumë raste kur qeveria komunale i ka devijuar projektet siç janë: shkolla në Turjakë etj.
- Kalimi i mjeteve në sulcit, kjo para ka humb dhe tani kanë mbetur shumë projekte pa u realizuar si vonesë e shpalljes së tenderave. Ky është keqpërdrim i buxhetit.

Kryetar, cilat janë borxhet e mbetura nga projektet sepse ju nuk i keni paraqitur në raport?

Hashim Vrenezi: Mendoj që me të vërtetë raporti duhet që të diskutohet në një mbledhje të veçantë. Në këtë raport ka shumë elemendete që ne nuk ka intersojnë prandaj është edhe vulimuno. Raporti duhet me qenë i drejtë dhe i shkruar qartë.

Kryetar, është shumë e rëndë që 1,5 mil€ me shku suficit e më i dënum qytetarët me mos investime kapitale. Ju krejt fajet po i bartni tek prokurimi por ne nuk po i dimë arsyet. Asnjë projekt nuk realizohet sipas pramasave dhe parallogarive. Projektet duhen të mbikqyrën më shumë.

Ne kemi kërkuar që të bëhet një analizë dhe një statistikë për çështjen e arsimtarve që në të bëjmë një vi buxhetore, ju nuk e keni bërë. Tash vjen një kërkesë pre Drejtorisë së Arsimit që t'u bëhet një zgjidhje çështja e arsimtarëve pensionistë.

Kryetar, ne kemi këkura me shkrim që t'na sillni një listë të pranimve teknike të të gjitha projekteve që kanë përfunduar. Ajo listë kurrë nuk ka ardh.

Raimonda Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Kryetar, pse asnjë projekt për Tërpezë nuk është realizuar të cilët janë votuar këtu? Arsyeja është sepse në ato lagje nuk ka fituar NISMA. Nuk është realizuar projekti i trotuarit nga shkolla deri tek 2 lagjet “Jahaj” dhe “Muhaxherët”. Kanalizimi për familjet në lagjen “Jahaj”, asfalti po për këtë lagje, rruga më kubëza që lidh po këto të dyja lagje.

Në këtë raport shkruan në faqen 21 që janë marrë pramasat dhe parallogaritë për për kryrjen e këtyre projekteve për ujëra të zeza, për asfaltim të rrugës, për ndriçimin publik dhe për trotuarin në Tërpezë, përveç ndriçimit publik projektet tjera nuk janë realizuar.

Në faqe 71, paisje laboratorike konkretizuese për shkollën “Hasan Prishtina” projekti është i shkruar 2 herë me dy kode të ndryshme. A është ky ndonjë problem teknik ose çka?

Alban Mazreku: Kryetar, mirëmbajtje dimëreo sivjet nuk ka pasur as hapje të tenderave, por ku kanë mbetur mjetet që kanë qenë të planifikuara?

Mjetet për ndërtimin e sallës së sporteve në Drenoc kanë shkuar suficit dhe ju nuk i keni tërhequr investimet nga Ministria dhe me fillu me ndërtimin e kësaj salle. Ashtu ka ndodh edhe me projektin e Pishinës Gjysmolimpike.

Kryetar ne si Kuvend i patëm nda 130,000.00€ për pagat e mësimdhënësve pensionistë, mësimdhësit nuk janë paguar, ku janë paratë?

Një sasi e mjeteve që janë ndarë për mamografinë janë shpënzuar ndërsa aparati mamografik nuk është blerë. Autoambulanta në Kjeve a është blerë a jo? A ka filluar ndërtimi i shkollës në Gurbardh apo jo?

Valon Krasniqi: Kryetar, ku mbeti fati i sallës sportive në Drenoc? A pritet që në një të ardhme të fillojnë punimet?

Ilaz Krasniqi: Në çdo fshat të K. së Malishevës kemi probleme me kanalizime. 500 m që është dashur që të rregullohet knalizimi, Kryesia e Fshatit në Carrallukë ka vendosur që ato t'i fut në kolektor shaku ikjes nga pusi me ujë të pishëm që furnizohet fshati. Çdo punë që po investohet nuk po menxhoheet mirë dhe neve po na kushton. Shumë shkolla kanë probleme me nxjemjen qendore dhe nuk e di se si bëhet pranimi teknik i këtyre projekteve që s'po punohen mirë. Kërkoni më shumë përgjegjësi nga ata që i mbikëqyrin këto projekte.

Kërkoj që edhe pika ku është Raporti i Komisionit për Emërtimin e Rrugëve të diskutohet sot.

Rrahim Morina: Meqë ora është 16, është mirë që ta përfundojmë mbledhjen për sot. Pjesën tjetër të mbledhjes e vazhdojmë të Hënën në ora 10. Shihemi të Hënën.

Pjesa e parë e mbledhjes përfundoi në ora 16:05.

*

*

*

Vazhimi i mbledhjes së III (tretë) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Malishevës

Mbledhja mbahet me datë 01.06.2020 dhe filloi në ora 10:30 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 17 asambleistë, drejtorë komunalë, LMT-ja, përfaqësuesi i OSBE-së, dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë! Vazhdojmë me pjesën e dytë të mbledhjes së III-të të rregulltë. Të pranishëm jemi 17 asambleistë, kourrumi është dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen.

Jemi në pikën e 8-të të rendit të ditës: Bartja e mjeteve financiare nga viti 2018, 2019 në vitin 2020. E ftoj drejtorin për fjalën.

Valon Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Të hyrat vetanake që grumbullohen barten nga një periudhë në një periudhë tjetër në qoftëse ato nuk shpenzohen brenda një periudhe fiskale.

Prandaj ne e kemi paraqitur këtë brajte nga fondet burimore 22 dhe 21 të cilat do të duhet që t'i bartim për periudhën 2020. Këto të hyra kanë mbetur nga disa projekte kapitale, mallëra dhe shërbime, subvencione si dhe nga kategoria e pagave.

Ne kemi menduar që këto të hyra duhet të barten në këto projekte. Projekti i rrugëve nga të dy anët prej urës kryesore në drejtim të urës së minitransitit afërsisht 97,000.00€, ndërtimi i rrugëve me kubëza në Lladroc dhe Astrazub diku 4 rrugë. Prej grantit të shëndetësisë, renovimi i QMF-së në fshatin Tërpezë, renovimi i QKMF-së në Malishevë, ndërtimi i Emërgjengjës 20,000.00€. Nga grandit i Arsimit 50,000.00€ janë të ndara për ndërtimin e fushave sportive, rregullimi i oborreve të shkollave si dhe inventarë për shkolla. Këto janë projektet që ne kemi propozuar që t'i bartim këto mjete 274,235.24€.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Si zakonisht na jepen gjysmëinformacione me jo të vërteta të plota lidhur me atë pse kërkohet bartja e mjeteve nga një periudhë në një periudhë tjetër. U përmenden disa projekte që janë ndarë mjete më heret pse duhet përsëri të ndajme mjete për të njëjtat projekte. Sa i përket fushave të sporteve kur është hap tenderi ju ka dhanë tenderi kompanisë më të shtrejtë. Kërkoj një shpjegim konkret. A është e vërtetë 50,000.00€ që janë paraparë nga të hyrat vetanake për projektin e fushave nuk kanë mund të realizohen me kohë aty dhe tani po kërkohet që e njëta shumë të bartet përsëri atje? 150,000.00€ kanë qenë të planifikuara në tërësi për fushat sportive, ndërsa kontrata e nënshkrime sipas tenderit është diku 200,000.00 e diçka€. Pra jemi afërsisht më shumë se 100,000.00€ më shumë. Si do të sigurohen ato mjete tjera? Ashtu duhet t'na informoni skatë edhe për rrugët me kubëza sepse nuk bëhet ljalë veç për ato dy fshatra që ju përmendet.

Ne për Emergjencën kemi ndarë buxhet dhe mjetet që janë të parapara për të të shkojnë për blerjen e aparatit të mamografisë dhe kërkoj që të përkrahet kjo kërkesë e jona e që shuma është 20,000.00€.

Projektet që janë paraparë në vitin e kaluar e që nuk janë realizuar janë l-kjoskat, anshensorin në QKMF etj. Është mirë që të heqen mjetet nga rruga për kah minitransiti e të kryhen disa projekte që janë më me prioritet.

Nebih Bibaj: Kot marrim vendime kur ato nuk gjejnë zbatim. Me 30.08.2019 kemi marrë vendim për bartjen e mjeteve financiare për ndërtimin e rreth-rrotullimit në rrugën “Ibrahim Mazreku” që lidhet rruga “Habib Berisha” në vlerë 20,000.00€. Pse nuk është realizuar ky projekt?

Vendosja e pengesave në rrugë 10,000.00€ kompania i ka shtruar ato pa asnjë centë, ku janë ato para?

Rruga “24 Marsi”, në Lladroc ka pas të shtrohet me kubëza, pse nuk është realizuar ky projekt?

Kur ne marrim vendim për disa projekte duhet t'i realizoheni ato projekte. Çka janë këto keqpërdorime. Ka projekte që janë më buxhet të planifikuara e ju përsëri me barten e mjeteve nga të hyrat vetanake po kërkon mjetet.

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë! Mjetet që nuk janë shpënzuar apo që kanë tepruar jam që të barten në projektet tjera. Nuk e kuptova këto mjete a do të barten për projektet e njëta apo për projekte të reja? Sipas tabelës këtu kërkoja që nga fshatrat që vi unë të ketë investime më shumë e sidomos në rrethojat e shkollave ashtu siç kërkoja të mërkurën.

Avdi Morina: Pershendetje! Kur flasim për bartjen e mjeteve për disa projekte këtu është dashur të jetë i pranishëm edhe drejtori i Urbanizimit sepse përndryshe është pa logjikë të diskutojmë për ato projekte. Ne duam sqarime për këto projekte.

Halil Morina: Pershendetje për të gjithë! Ne njëherë e kemi bërë këtë bartje prej një viti në vitin tjetër, tash po i bjen që po e bëjmë një ribartje të këtyre mjete pothuajse për të njëjtat projekte. Në parim jam që të barten këto mjete, por të ndryshohen projektet e të implemtohen këto projekte ose për ndryshe s'po i votojmë hiq.

Hashim Vrenezi: Bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake është si pasojë e mos menaxhimit të financave në formën e duhur. Ka projekte që nuk janë realizuar fare, por ka projekte që janë realizuar e kanë tepruar mjetet. Në së pari është dashur ta kemi të saktë këtë informatë. Ne duhet të dimë edhe cilat projekte janë të planifikuara me buxhet edhe pse ne duhet t'u ndajmë mjete përsëri për ato projekte. Kërkoj nga drejtori që le t'na sjellë informacionet që kërkoja e masandej ne mund të marrim vendim për t'i bart mjetet.

Arlind Morina: Pershendetje për të gjithë! Njëjtë edhe unë pata kërkuar një gyp për ujësjellësin në rrugën “Qarri” atëherë kur u miratua buxheti, por përsëri e shoh që është me këto projektet këtu me bartjen e mjeteve vetanake.

Rrahim Morina: Fjalën e ka drejtori.

Valon Mazreku: E keni aty me material që nga granti i arsimit dhe ai i shëndetësisë nuk lejohet bartja e këtyre mjeteve në grante tjera përveç aty ku kanë tepruar.

Për QMF-në në Terpezë nga të hyrat vetanake ne nuk kemi ndarë mjete asnjëherë dhe është projekt i vitit 2020. Për shkak të gjndjes së objektit përveç planifikimit buxhetor është dashur që të rriten mjetet sipas paramases dhe parallogarisë dhe ne i kemi shtuar 8,000.00€.

Për fushat sportive 150,000.00€ kanë qenë të buxhetuara për vitin 2019 po nga ky projekt kanë tepruar 50,000€. Të hyrat e mujit nëntor dhe dhjetor nuk mund t’i zotojmë në atë kohë sepse mbyllet periudha prandaj edhe barten.

Nebih, sipas ekspertëve të urbanizmit aty tek lagjia e “Gurit” nuk duhet të ndërtohet rrethi dhe mjetet janë këtu që po kërkojmë që t’i bartim. Ka edhe vlera të vogëla e që ne i kemi mbledh e i keni në material se ku po dojmë t’i çojmë. Sa i përketë asaj se pse nuk janë kryer projektet është drejtorja përkatëse që do t’u jep përgjigje.

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Mjetet që janë ndarë për rregullimin e rrugës në të dy anët e lumit Mirusha mu duk e paarsyeshme kur kemi projekte më me prioritet e që mund të realizohen.

Sa i përketë mamografisë ne kemi staf e ju duhen 3 muaj trajnim për përdorimin e tij. Nuk e di se çka po ndodh me mamografinë edhe pse mjetet i ndajmë aparati nuk është askund.

Kastriot Berisha: Pershendetje për të gjithë! Kur ne po diskutojmë për bartjen e mjeteve vetnake nëpër projekte këtu është dashur të jetë i pranishëm gjithqysh drejtor i Urbanizmit.

Për të marrë vendim për bartjen e mjeteve ashtu siç po kërkohet ne duhet të kemi informacione pak më të detajuara.

Nëse për një projekt është ndarë me buxhet një shumë e caktuar dhe projekti kur fillon të realizohet kërkon mjete më shumë sigurisht nëse ne i shohi dokumentet do t'i bartim ato mjete. Ka shumë vendime që ne kemi marrë këtu e nuk kanë gjetë zbatim. Për këtë kërkoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër e drejtori t'na sjellë informacione të sakta.

Luan Kryeziu: Pershendetje për të gjithë! Ne në kohën e pandemisë si Kuvend i kemi ndarë 150,000.00€, e nëse nga kjo shumë është dëmtuar ndonjë projekt e për këto projekte është mirë që të barten mjetet vetanake.

Rrahim Morina: Për këtë pikë i kemi 2 mundësi. Votimin ashtu siç ka ardh me material apo shtyrja ashtu siç e kërkuat disa nga ju.

Avdi Morina: Kjo pikë nuk duhet të shtyhet por mund ta bëjmë ndonjë modifikim të vogël që kërkohet sepse për këtë më shumë pësojnë qytetarët. Ne mund ta marrim një pauzë të vogël për konsultime dhe modifikime për bartjen e këtyre mjeteve.

Liridon Hoti: Pershendetje për të gjithë! Profesoreshë, je shumë e pasinqertë në atë që the. Ne kemi mungësë të stafit për aparatit e mamografisë, nëse veç blehet ky aparat stafi së paku 6 muaj duhet të trajnohet për këtë. Jam bashkëpunues sa herë që doni mund t'ju takoj, por ju lutem mos jepni dezinformata këtu.

Hajdin Berisha: Pershendetje për të gjithë! Sai përketë aparatit të mamografisë shumë çështje lidhen zingjirë. QKMF në Malishevë dhe të gjitha tjerat nëpër Kosovë nuk kanë një statut të mirtuar. Në këtë konteskt blerja e aparatit të mamografisë do të ishte mirë që të parashihej me këtë statut. Kuadër aktual për këtë aparat nuk kemi, hapësira është duke u rritur dhe kushtet për të po krijohen. Ne nuk kemi asgjë kundur nuk kemi për aparatit e mamografisë.

Alban Mazreku: Unë i dëgjova parafolësit dhe pajtohem që shuma 20,000.00€ që është për ndërtimin e Emërgjecs të kalojnë për aparatit e mamografisë.

Valon Krasniqi: Grupi ynë politik kërkon 5 min pauzë për konsultime rreth bartjes së këtyre mjeteve.

Alban Krasniqi: Edhe ne pajtohemi që të kemi një pauzë të shkurtër për konsultime.

Rrahim Morina: Dalim në pauzë për konsultime.

Vazhdojmë me mbledhjen. Shefat e grupeve o dakorduan dhe kemi bërë disa ndryshime sa i përketë bartjes së mjeteve vetanake. Po i lexoj ndryshimet.

Projekti për rregullimin e rrugëve nga të dy anët e lumit Mirusha nga ura në rrugën kryesore në drejtim të minitransitit ka 9,256.85€, ndërtimi i rrugës me kubëza në Lladroc dhe Astrazub është 40,000.00€, l-kjoska është 10,000.00€, aparatati i mamografisë 20,000.00€, ndërtimi i objektit të QMF-së në Tërpezë 10,000.00€, ndërtimi i Emërgjencës 20,000.00€, ndërtimi i fushave sportive Bardh, Carrallukë, Gullbovc dhe Lladroc është 50,000.00€, rregullimi i oborrit të shkollës në Bubavec, Llozicë dhe Kjevë 15,078.00€ dhe ivetarë për shkolla është 20,000.00€ në Bardh dhe Lladroc. Kush është pro këtyre ndryshimeve?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me këtë votim aprovohet bartja e mjeteve vetanake nga viti 2018 dhe 2019 në vitin 2020.

Kalojmë në pikën e 9-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/410 datë:12.05.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, lidhur me zbatimin e kontratës kolektive të Arsimit dt.17.04.2017.

Për këtë çështje Kryetari, unë dhe Blerimi kemi qenë në Prishtinë dhe jemi taku me zv. Ministrin e Finacave dhe ata thanë që nuk lejohet bartja e mjeteve nga investimet kapitale në paga dhe medijtje. Mjetet që ne i marrim Ministria i qet në muajin dhjetor e ato mund të shkojnë suficit. Ne mund ta debatojmë këtë pikë por vendim nuk mund të marrim për këtë çështje.

Blerim Thaçi: Persheendetje për të gjithë! Në takimin që përmendi Kryesuei ndqrr të tjera zv. Ministri tha çështjen e pagave përcjellëse do ta çojnë në Gjykatën Kushtetuese sepse është në kundërshtim me disa ligje. Realizimi i vetëm i tyre është përmes gjykave edhe pse si realizim

edhe ai është në kundërshtim me ligjin. Është mirë që ata të paguhen nga pagat dhe meditet sepse pa pagë nuk mbetet asnjë puntorë sepse i kompenzon Ministria.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Nebih Bibaj: Drejtor, a kanë ndërmarrë ndonjë gjë për ta dërguar në Gjykatën Kushtetuese, a janë të ekzekutushme këto lëndë?

Nënkryetar, me vendim ne i kemi ndarë 1,016,000.00€ për paga përcjellëse dhe jubilarë. Paret nuk i kanë marrë pensionistët por ku kanë shku këto para?

Hashim Vrenezi: Drejtor, ju thatë që kërkesën nuk e keni sjellë ju. Këtu në kërkesë shkruan nga z. Blerim Thaçi. Kjo pikë duhet të diskutohet sepse mësimdhënësit duhet të informohen.

Ne e patëm ndarë një shumë të fondeve nga investimet kapitale për këtë mësimdhënësit ata nuk janë paguar kurrë e mjetet janë shpenzuar e informacione kurrë nuk kemi marrë. Kjo informatë që e keni marrë tani për mua është e vonuar sepse kjo është dashur të ndodh kohë më parë.

Hidajete Mazreku: E drejta e marrës së këtyre pagave është e ngaratur me ligj. E kam thënë edhe më heret që avokati i komunës të bëjë një marrëveshje që për të gjitha rastet që biles shpenzimet e përmbarusit dhe shpenzimet e gjykatës kur bëhen ankesat të mos paguhen.

Avdi Morina: Me këtë problem ballafaqohen të gjitha komunat. Kur është nënshkru ligji për Kontratën Kolektive asnjëra qeveri nuk e ka rregullu çështjen e pagesave. Duhet me kriju një kod të veçantë për këto pagesa. Këtë çështje do të ishte më mirë ta rregullonte Asosacioni i Komunave që ta përcjellë për Parlament.

Luan Kryeziu: Kryetari përmes kësaj kërkesë ka kërkuar që t'i japim zgjidhje kësaj çështje me plotësisht të drejtën e mësimdhënëseve pensionistë. Nëse e kërkojmë fajin, ai ka një daresë e është Ministria e Arsimit sepse kur është nënshkruar ky ligj është dashur të parshihet edhe çështja e pagesave. Kryetari po kërkon se ku të hiqen këto mjete që të mos dëmtohem edhe më shumë nga gjykata. Prandaj ne është mirë që mos të lëjmë që të rriten problemet dhe të gjejmë një zgjidhje.

Alban Krasniqi: Ligji për Kontratat Kolektive ka 10 vjet që është duke u diskutuar por nuk e di pse edhe nuk i kanë shqyrtu edhe mundësinë e pagesës. Ky ligj është nënshkruar në kohën e zgjedhjes dhe ka qenë më shumë për fushatë elektorale. Ne nuk kemi një sindikatë të mirëfilltë të arsimit se ajo nuk merret me asnjë çështje apo problem tjetër që ka të bëjë me fushën e arsimit përveç asaj që ka kërkuar që të rriten pagat. Si pasojë e kësaj marrëveshje ne po i vuajmë sot pasojat dhe po dëmtohen buxhetet komunale.

Realisht për këtë komunat nuk janë përgjegjëset kryesore për zbatimin e kësaj kontrate por është Ministria e Arsimit dhe kjo çështje duhet të adresohet në Parlamentin e Kosovës.

Demir Bajraj: Pershendetje për të gjithë! Është mirë që mos të merremi shumë me të kaluarën por të provojmë t'i japim zgjidhje problemit. PDK-ja është ajo që ka bërë më shumë për mësimdhënësit.

Drejtor, a ke informacione që ndonjë mësimdhënës i ka marrë këto mjete përmes gjykatës?

Alban, të lumtem mos më ndërprej sepse unë ty po të dëgjoj kur po flet!

Blerim Thaçi: Vendimet gjyqësore janë të ekzekutueshme Nebih. Ky nuk është faji ynë për këtë ligj.

Demir, janë pagur vetëm pagat jubilarë ndërsa për shujta nuk është bërë asgjë. Këta mësimdhënës e kanë të drejtën tyre dhe ata le t'i ndjekin procedurat ligjore.

Ne kemi qenë në takim në Ministrinë e Financave pasi është bërë kjo kërkesë. Ne krejt çka mund të bëjmë është që kur të vjen një vendim i gjykatës të mos bëjmë ankesë bile mos t'i bëjmë këto shpenzime tjera shtesë që për një rast janë diku 600€.

Rrahim Morina: Pas këtij debati kalojmë në pikën e 10-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/416 datë:14.05.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës për gjetjen e mundësisë së zgjidhjes për familjet të cilat duhet të zhvendosen me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në lagjen Matoshi në Malishevë. Meqë Kryetari nuk është këtu shkojmë me deklaratimet e shefave të grupeve që a duhet apo jo të diskutohet kjo pikë.

Sylë Dukolli: Kjo është çështje e ndjeshme dhe duhet me qenë Kryetari këtu kur të diskutojmë sepse është kërkesë e tij. Pra logjikisht pa Kryetarin duhet të shtyhet.

Alban Mazreku: Pvarsisht që nuk është Kryetari këtu ne kërkojmë që të krijohet një Komision për të gjithë ato familje që do të futen në qendren e banimit social të jetë nga secila parti politike nga një përfaqësues si dhe njëri nga anëtarët e atij komisioni të jetë edhe një përfaqësues i Kryetarit.

Rrahim Morina: Meqenëse Nënkryetari erdhi ja japim fjalën atij.

Hajdin Berisha: Përmes kësaj kërkesë kërkohet që të gjendet një zgjidhje për ato 4 familje. Ajo ndërtesë kolektive duhet të rrënohet sepse aty po ndërtohet shkolla.

Hashim Vrenezi: Nënkryetar, kur funksionalizohet objekti i banimit social? Deri sa të funksionalizohet objekti i banimit social propozoj që këto familje t'i vendosim në banesa me qera dhe t'i mundësojmë operatorit ndërtimin e duhur të shkollës sipas projektetit dhe afatit kohor. Komuna duhet t'ua paguaj qeranë këtyre familjeve.

Ne kemi propozimin për ndërrimin e anëtarit për atë Komision e Trajtimin të Familje të Pastreha që Ali Morina të zëvendsohet me Alban Mazrekun.

Alban Krasniqi: Kryesues kërkoj që propozimi për zëvendësim të anëtarit për atë Komision të votohet në pikën e rendit të ditës Të ndryshme e çështjen mos ta ngatëroojmë me këtë pikë për të cilën po diskutojmë.

Ka pak mangësi në dokumente rreth asaj se kush e ka të në posedim këto banesa jo në pronësi, ata ndoshta duhet që t'i kompletojnë edhe pak dokumentet për shfrytëzimin e këtyre banesave për të drejtën e shfrytëzimit që ne këtë të drejtë t'ja bartim për një vend tjetër. Kjo çështje është e ndjeshme.

Si një ndër zgjidhjet është që deri sa të funksionalizohet objekti për banimin social përkohësisht t'i vendosim këto familje në banesa me qera. Ne ashtu kështu duhet t'ju bëjmë një zgjidhje të dinjeteshme këtyre familjeve.

Banimi social nuk ka të bëjë me skemën sociale. Kështu që këtyre duhet me ju njoftë të drejtëne tyre e t'i vendosim në objektin e ri social.

Rrahim Morina: Vendimin për ndërtimin e kësaj shkolle e ka marrë ky Kuvend. Në lokacionin ku do të ndërtohet shkolla është kjo shtëpia ku duhet të rrënohet dhe prandaj e kemi për obligim që t'ju bëjmë një zgjidhje këtyre familjeve deri sa t'ju bëjmë një zgjidhje të përhershme. Mendoj që këto 4 familje duhet që pa konkurrencë të vendosen në objektin e banimit social kur të funksionalizohet sepse ne ju kemi marrë të drejtën e banimit këtu dhe duhet që t'ju sigurohet banimi i sigurtë atyre.

Komisioni është i formuar dhe bëjë thirrje që edhe NISMA të propozoj anëtarin e vet si dhe Kryetari të sjellë përfaqësuesin e tij e ta kompletojme këtë komision.

Propozoj që ne ta autorizojmë Kryetarin që të bëjë një zgjidhje të përkohëshme për këto familje deri sa të rregullohet banesa për banimin social.

Hajdin Berisha: Ne po dumë të bëjmë zgjidhje të përkohëshme. Kjo zgjidhje është në dy variante. Ose duhet t'u pagujmë ndonjë banim me qera ose duhet t'i vendosim në banesat e vjetra të banimit social.

Rrahim Morina: Pra ju po pajtoheni që Kuvendi të autorizojë Kryetarin që të bëjë një zgjidhje të përkohëshme për 4 familje deri sa të bëhet zgjidhja e përhershme. Kush është për?

Për: 19 (unanimisht)

Avdi Morina: Ne NISMA propozojmë Luan Kryeziun anëtarë të atij komisioni.

Rrahim Morina: Kemi 2 propozime për plotësimin e Komisionit për Familjet e Pastreha. PDK propozoi që Ali Morina të zëvendsohet me Alban Mazrekun dhe NISMA propozoi që Luan Kryeziu të jetë anëtar i këtij Komisioni. Kush është për?

Për: unanimesh

Kalojmë në pikën e 11-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve dhe emërtime të reja. Unë kam qenë Kryetar i këtij komisioni dhe po ju them disa fjalë.

Kemi bërë një punë e mirë dhe kemi përmbyllur një proces që ka qenë i hapur që sa kohë. Fillimisht Aliu ka qenë kryetar i këtij komisioni por pas punësimit të tij jam bërë unë. Ne kemi sjellë një raport e që ju e keni para jush. Kërkoj që ta votoni këtë raport.

E hapi debatin për këtë pikë.

Demir Bajraj: Në Panorc, rruga “Xhemali Bajra” e kanë dërgu në një lagje kur e ka meritë ndonjë rrugë më kryesore ta ketë këtë emër. Ka edhe dis emra që nuk janë të përshtatshëm dhe do të ishte mirë që ju të bisedoni me banorët e fshatit që të jemi të gjithë të kënaqur.

Unë nuk jam që të votohet ky raport sepse ka shumë rrugë që janë të emërtuar me familjarë.

Luan Kryeziu: Ky raport është i mangët duke filluar nga mbledhjet që janë zhvilluar sepse nuk figuron se sa mbledhje janë mbajtur. Këtu kemi një raport me emra dhe ndryshime ku ka nevojë për plotësime. Ka disa raste kur kërkesat refuzohen por nuk jepen arsyetime. Psh nr. 42 lagjia “Balaj” shkruhet që kërkesa aprovohet pjesërisht nuk jepen saqirime tjera. Ja edhe disa raste që po i përmendi.

Mendoj që ky raport duhet të shtyhet e të punojë edhe pak komisioni deri në plotësimin e këtij raporti.

Gjithëashtu ky komision ka mosbashkëpunim me kryetarët e fshatrave sepse nuk janë konsultuar për raste ku ka pasur kërkesa dhe ankesa.

Avdi Morina: Në bazë të këtij raporti puna e këtij komisioni në një pjesë ka qenë puro politike dhe në një pjesë ku është ra viktimë e disave. Kur vendoset që të kryhet një punë e mirë duhet të vendosen edhe parimet e jo këto parime diku të vëlejnë e diku jo. Diku janë aprovu emrat e familjarëve e diku jo. Ka raste të tilla, ja në fshatin tim. Psh: kërkesa është refuzuar pasi kryesia e fshatit ka kërkuar që të mos bëhen ndryshime me emrat e vendosur ë heret nr. 150 sipas renditjes.

Sylë Dukolli: Unë kam qenë anëtar i këtij komisioni. Ne jemi mundu që mos me vendos emra të familjarëve përveç në raste kur bëhej fjalë për dëshmorë. Demir, respekt për Xhemali Bajrën.

Këtij komisioni veç mos i jepni konetacion politik sepse ne jemi munduar se sa më pak të ishim politik dhe jemi kunduar që t’ju japim meritë figurave historike. Kërkoj që më mirëkuptimin e juaj votoni këtë raport sepse jemi munduar të punojmë siç duhet.

Demir Bajraj: Kërkoj që t’me jepni 3-4 ditë afat e të sjelli një raport nga kryesia e fshatit. E ju më pas vendosni për emrin ashtu siç ju mendoni që është më mirë.

Ilaz Krasniqi: Ne si komisioni kemi shqyrtuar ankesat dhe kërkesat e qytetarëve dhe ne vetë nuk kemi bërë emrime të reja.

Gjatë punës së këtij komisioni kemi vë re që pothuajse historia ka fillu me brezin tonë. Propozimet shumica kanë ardh për emra të familjarëve. Do të ishte mirë që t'ja bëjmë si Prishtina që vet komisioni t'i bëjë listat e emrave për emërtimin e rrugëve. Ka pasur shumë pak emra të propozuar të femrave. Me kërkesën tonë dhe të shoqiatave të dalura nga lufta janë vendosur 4 emra më dinjitoz duke përfshirë edhe emrin e Xhevë Lladrocit.

Ka pasur raste që kanë ardh propozime edhe me emra të njerëzve të gjallë. Ne si komision kemi pyet dhe kemi vendosur bashkarisht për çdo emër.

Valon Krasniqi: Nëse lista përfundimtare ka gabime unë jam që ajo të përpunohet e të vije në një mbledhje tjetër. Po sido qoftë ashtu siç vendosni ju ne votojmë.

Filloreta Bytyqi: Pershendetje për të gjithë! Kam një kërkesë nga bonorët e fshatit tim që rruga “Kuk Ndreu” të zëvendsohet me emrin “lagjia e Muçajve” sepse për banorët e asaj lagje është i papranueshëm ky emër.

Kushtrim Zogaj: Gjatë punës në këtë komision kam konsultuar që edhe nëse punojmë me vitë të tëra ne kësaj pune nuk mund tr'ja qesimin “pikën”. Mendoj që është bërë punë e mirë sigurisht që gjatë një pune të gjatë edhe mund të bëhen lëshime.

Rrahim Morina: Mbase s'ka debatues të tjerë shkojmë në votim. Kush është pro miratimit të Raportit të Komisionit për Emërtimin e rrugëve me 4 rekomandime?

Për: 17

Kundër: 6

Abstenim: 1

Me këtë votim aprovohet edhe ky raport.

Kalojmë në pikën e 12-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe paraqitja në debat-konsultim publik i draft-Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve. Kryetar i këtij komisioni është Valoni dhe ai e ka fjalën.

Valon Krasniqi: Ky komision ka mbajtur 5 mbledhje dhe e ka shqyrtuar në tërësi këtë rregullore si dhe duke bërë plotësim-ndryshimimin e saj në harmoni me kërkesat e qytetarëve. Çdo ndryshim është bërë konformë me ligjet në fuqi. Ne presim që më propozimet e juaja kjo rregullore të plotësohet dhe të rregullohet ashtu siç e meriton. Andaj kërkoj që kësaj rregullore t'i jepet leja për dëgjim publik, e më pas të kthehet këtu për votim.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë. Atëherë mbase kërkon që të shkoj njëherë për dëgjim publik e hedhi në votim. Kush është për që kjo rregullore të shkoj në dëgjim publik?

Për: unanimsisht (19)

Me këtë votim Rregullorja për Subvencione dhe Transfere shkon për debat publik.

Kalojmë në pikën e 13-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit të pasurisë jo financiare në Komunën e Malishevës. E hapi debatin për këtë pikë.

Hashim Vrenezi: Kërkesat që dalin prej KPF-së janë shumë të arsyeshme. Ne nuk i dimë se cilat janë pasuritë tona publike që ndoshta mund t'i ofrojmë për shërbim e mund të krijojmë të hyra për komunën tonë. Kërkoj që deri sa nuk kemi material për këtë pikë nuk kemi kevojë që ta trajtojmë. Drejtori i Financave ose përsone kompetentë duhet t'na sjellë informatat që kemi kërkuar.

Alban Krasniqi: Ne jemi duke të fol për pasurinë të tërësishme të k. së Malishevës. Ne kemi kërkuar të dimë se ku janë ato hapësira që i ka në pronësi komuna. Ne nuk kemi marrë informacione nga ekzekutivi për gjendjen e kësaj çështje. Ne e kemi bërë një kërkesë dhe kërkoj nga drejtori i Financave dhe në bashkëpunim me drejtoritë tjera t'na sjellin një raport në formë tabelare. Ky lloj informacioni është shumë i rëndësishëm për ne.

Rrahim Morina: Pra ju po kërkon që me vendim të Kuvendit të obligohet Kryetari i Komunës që t'na pajisë me material plotësues për këtë pikë të rendit të ditës për mbledhjen tjetër. Kush është për?

Për: 12

Kundër: 0

Abstenime: 7

Me këtë votim obligohet Kryetari i Komunës që për mbledhjen tjetër ta siguroj materialin e nevojshëm për këtë pikë.

Kalojmë në pikën e 14-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raporti vjetor të punës të Drejtorisë për Inspektorat për vitin 2019. Drejtori e ka fjalën.

Dibran Kastrati: Pershendetje për të gjithë! Ky raport pasqyron gjithë punën, aktivitetin e kësaj drejtorie për vitin 2019. Drejtoria jonë detyrat dhe kompetencat e saj i bazon çdo herë në ligje. Inspektorët tanë nga puna në terren dhe nga puna në zyre asnjëherë nuk veprojnë në kundërshtim me ligjin.

Drejtorja e Inspektoriatit gjatë vitit 2019 ka arkëtuar gjithësej 740€ nga gjobat mandatore, 370€ nga licensimet e subjekteve afariste. Detajet e tjera i keni në raport.

Në drejtorinë tonë mbrenda kësaj periudhe kemi pasur 72 kërkesa e ankesa prej të cilave 70 prej tyre i kemi shqyrtuar në konformë ligjeve në fuqi. I kam ndarë të gjithë sektorët veç e veç po ju raportoj edhe unë për këtë edhe pse të tërin e keni të pasqyruar në raport.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Janë 5 sektorë mbrenda Drejtorisë së Inspektoriatit i tregut, i ndertimit, trafikut, i tregut dhe i ambientit.

Sa i përket sektorit të trafikut ne i kemi parë disa pengesa që janë vendos në rrugë në hyrje dalje të Malishevës dhe të gjithë e kemi parë kualitetin, standardin e tyre. Ato nuk plotësojnë asnjë kriter për vendosjen e tyre e Inspektoriatit s'ka bërë asgjë për këtë. Nuk ka shenja as në rrugë e as afër shkollës.

Ne e kemi PZHK dhe ju është dashur që ta respektoni atë, sepse po dëmtohet toka bukës e askush nuk del me pa se çka po bahet aty. Ndërtohet nën tensionin e lartë dhe inspektorët e ndërtimit nuk e di a po i shohin këto. Ka plot e raste të tjera. Me sektorin e ndërtimit duhet të ndërlihet edhe sektori i mjedisit. Në Malisheë ndërton çka të duash e si të duash e askush nuk vjen me t'pa se çka po bënë. Këto elemente drejtor duhet që t'i keni parasyesh.

Drejtor nuk mund t'më flasësh asgjë për mjedisin kur depoja e mbeturinave të "Eko-Regjionit" është ende aktive këtu. Nuk kryhen puntë veç me një procesverbal, por kur sanohen dëmet.

Ilaz Krasniqi: Drejtor, përgjegjësia e juaj është që të organizoni punën në zyre e ndërsa më shumë ju shohim juve në terren se sa inspektorët. A keni vetura në dispozicion ju si drejtori? M'ka ndodh që inspektorët i kam marr me veturën time në një rast sepse thanë që s'kanë veturë.

Sa i përketë inspektoriatit të tregut ka disa vite që nuk e keni zbatuar Rregulloren për orarin e punës. Më heret ka pasur një ditë pushim, tani kush do punon sa të do e hap e mbyll biznesin kur të do.

Drejtor, a janë të kontrolluar peshoret për barashdim nëpër të gjitha bizenset?

Kam të dhënë që sallonet e ondolimit për meshkuj dhe femra, kafeteritë, supermarketet etj nuk kanë librezat sanitare. Sa qëndron kjo?

Cili duhet me qenë profesioni i inspektorit të ndërtimit?

Drejtor, ju jeni shku në Llozicë, e keni inspektu ndërtimin e xhamisë por pse nuk janë ndalur punimet kur ai projekt nuk i ka dokumentet e kompletuara më së pari nuk e ka vendimin e Kuvendit?

Ne të gjithë i kemi parë të parkuar para komunës autobusët kombibusët në rrugë dhe inspektoriatit nuk merr asnjë mas për këtë veprim.

Valon Krasniqi: Drejtor, nëse ju arrini që t'i ndalni furrat e gëlqerës dhe djegjen e gomave atëherë me të vërtetë është një e arritur e madhe. Neve na duhet një afat kohor se kur do të vini e ta pastroni ambientin në pjesën ku është bërë djegja e gomave. Në dorë e keni me ju dhanë leksion qeverive të kaluara.

Behije Sertolli: Sa i përketë këtij raporti do të ndalem tek inspektoriatit sanitar dhe ai i mjedisit. Ne si komision i arsimit kemi bërë disa vizita nëpër shkolla dhe dezinfektimi i shkollave është i obliguar në çdo fillim viti shkollor, ka pas raste kur kjo nuk është bërë dhe edhe pse është lajmëruar inspektoriatit ju nuk keni marrë masa edhe pse e keni marrë shkresën nga niveli qendror. Pse nuk i keni dezinfektuar ato objekte kur e keni marrë shkresën?

Sa i plotësojnë lokalet kushtet ato lokale që janë përreth shkollave? A i keni inspektuar? Sipas raportit thuhet që i keni bërë disa ndërprerje në fshatin Banjë dhe Kërvasari për gurthyesit por jo edhe në Bellanicë. Pse nuk i keni marrë masat para se me fillu me punu këta operatorë? Pas ndërprejes së punës së këtyre gurthyesëve që nuk i plotësojnë kriteret a do të merrni ndonjë mas për sanimin e gjendjes ku veprojnë ata?

Nebih Bibaj: Drejtor, a ke krijuar kod ekonomik për drejtorinë tënde apo ende paguhesh prej bujqësisë?

Vlerat e analizës së gordhjes së peshqeve ju kanë dal me vlera normale por nuk kanë ardh nga AVUK-u, ne e dimë se sa peshqit kanë ndodh si është e mundur kjo?

Drejtor, ju nuk jeni në gjendje me procedu ndonjë rast për billbordat edhe pse i vendosin para komunës e nuk i keni zbatuar as vendimet e Kuvendit. Largoni ata billborda.

Shkolla në Panorc a ka leje për ndërtim?

Sylë Dukolli: Sa i përketë këtij raporti mendoj që është i kompletuar dhe është i përgatitur mirë. Kërkoj që të mbikëqyrni rrjetin e marketeve në çmime. Kontrolllojeni më shumë sepse luajnë shumë më çmime. Të njëjtin artikull e gjenë herë më shtrejtë e herë më lirë e sidomos në këtë kohë pandemie i kanë rritë çmimet. A keni shqiptuar ndonjë gjobë për këtë.

Dibran Kastrati: Alban, projekti për vendosjen e pengesave në qytet ende nuk ka përfunduar caktimi për vendosje e tyre është bërë në bashkëpunim me Ministrinë e Transportin dhe kur të përfundojë projekti sigurisht që do të vendosjen edhe shenjat e komunikacionit.

Objekti fetar që është duke u ndërtuar në Llazicë ka leje ndërtimore.

Valon, gjatë mandatit tim po t'premtoj që ka për t'u pastruar fshati Bardh.

Behije, ne i kemi dhënë 2 urdhëresa edhe Drejtorisë së Arsimit edhe asaj të Shëndetësisë për të bërë dezinfektimin e të gjitha objekteve por për shkak të procedurave të tenderimit nuk është bërë dezinfetimi me kohë por gjatë kohës së pandemisë është bërë.

Të gjitha lokalet rreth shkollave janë inspektuar dhe ato të cilat nuk i kanë plotësuar ato kritere janë marrë masat e duhura.

Rrahim Morina: I kemi edhe 3 pika të rendit të ditës që dojnë veç votim.

Kush është pro që të miratohet Raporti i punës së Komitetit për Komunitete?

Për: 17

Kundër: 1

Abstenim: 0

Me këtë votim miratohet edhe raporti i punës së Komitetit për Komunitete.

Kush është pro miratimit të Raportit të Punës së Komitetit për Diasporë?

Për: 17

Kundër: 1

Abstenim: 0

Me këtë votim aprovohet edhe Raporti i punës së Komitetit të Diasporës.

Kush është pro miratimit të draft-Planit të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020?

Për: 16

Kundër: 1

Abstenim: 1

Me këtë votim aprovohet edhe draft-Planit të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020.

Është edhe kërkesa e Kryetari të Komunës për formimin e Këshillit Organizativ për Ndarjen e çmimeve për 16-Qershorin. Ky Këshill përbëhet nga Kryetari, Kryesuesi, shefat e grupeve, përfaqësuesi nga shoqatat e dalura nga lufta dhe një anëtar nga ojç. Kush është pro që të formohet ky Këshill?

Për: unanimitet.

Duke ju falemnderuar për pjesëmarrje me kaq mbledhjen e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 16:50.

Procesmbajtësja: Samire Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina

